



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:177619
Datë: 23.10.2024
Numri i dokumentit: 06336783

Ac.nr.8015/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Halide Reka e Lumni Sallauka - anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.K., nga Suhareka, të cilën me autorizim e përfaqëson av.Xh.B., nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Suharekës - Drejtoria Komunale e Arsimit të cilën e përfaqëson A.B., me objekt kontesti kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - dega në Suharekë, C.nr.671/20, të datës 01.11.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **21.10.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Suharekës - Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa pika **I (një)**, **II (dy)** dhe **IV (katër)** e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - dega në Suharekë, C.nr.671/20, të datës 01.11.2022, **VËRTETOHET**.

II. Pika **II (dy)** e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - dega në Suharekë, C.nr.671/20, të datës 01.11.2022, *mbetet e pashqyrtuar*.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.671/20, të datës 01.11.2022, në pikën **I (një)** të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit I.K. nga Suhareka. Në pikën **II (dy)** të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Komuna e Suharekës - Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësit në emër të pagesës së shujtave ditore për periudhën 18.04.2017 deri me 30.06.2022 për 838 ditë pune t’ia paguaj shumën prej 1,812.00€ me kamatë ligjore 8% duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë që si datë merret 16.12.2020 deri në përmbushjen definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm. Në pikën **III**

(tre) të dispozitivit, e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë për kompensimin e shpenzimeve të shujtave ditore në vlerë 232.00€ për 116 ditë pune për vitin shkollor 2016/2017 dhe 2017/2018, për shkak të parashkrimit. Në pikën IV (katër) të dispozitivit, e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 260 euro (dyqindëgjashtëdhjetë euro), brenda afatit të paraparë si në pikën I të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin e paraparë ligjor ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të *shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, , me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar ashtu që aktgjykimi i goditur të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazë ose aktgjykimi i atakuar të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditësit me propozim që Gjykata e Apelit të refuzoj si të pa bazuar ankesën e të paditurës dhe të vërtetoj aktgjykimin e atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- *Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datën 16.12.2020 ka ushtruar padi në gjykatën shkallës së parë, kundër të paditurës Komuna e Suharekës, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, me arsyet sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe dëgjimit të palëve ndërgjyqëse, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.671/20, të datës 01.11.2022, e ka aprovuar pjesërisht si të themeltë kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Nuk është kontestuese se paditësi punon te e paditura gjegjësisht në SHFMU “Shkëndija” në Suharekë dhe nga viti shkollor 2016/2017 deri në vitin shkollor 2021/2022 i ka gjithsejtë 1022 ditë përvojë pune siç u cek më lart. Njëherit nuk është kontestuese se e paditura është e obliguar që t'ia paguaj paditësit shumën prej dy euro në emër të shujtës ditore për çdo ditë të punës sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë dhe Ligji i Punës nr.03/L-212. Kontestuese mes palëve ndërgjyqëse është vetëm çështja se për sa ditë përvojë pune duhet t'i paguhet shujta ditore paditësit duke e pas parasysh parashkrimin e kërkesës. Andaj, gjykata e shkallës së parë ka vendosur t'ia njoh të drejtën paditësit në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, të ushqimit gjatë ditëve të punës dhe shpërblimit jubilar, duke u

bazuar në nenin 35 par.7 të Kontrata Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017. Për kamatën ka vendosur në bazë të nenit 82 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës konform nenit 452 par.1 të LPK-së, *(më gjerësisht si në arsyetim të aktgjykimit të atakuar)*.

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Po ashtu gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe disa fakte vendimtare nuk kanë qenë kontestuese. Nga provat që ka administruar gjykata e shkallës së parë është vërtetuar se paditësi I.K. është i punësuar tek e paditura si mësimdhënës në SHFMU “Shkëndija” në Suharekë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, kjo për arsyeje se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 të datës 01.11.2010, përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*.

Po ashtu me nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi me datën 18.04.2017, përcaktohet se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Andaj mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur si në dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses

si të bazuar, për çka edhe vendosi që të njëjtën ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Pretendimi ankimor i të paditurës se *gjkata e shkallës së parë gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë e ka konstatuar gjendjen faktike me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit*, pasi që me nenin 46, paragrafi 2 të Marrëveshjes Kolektive të Arsimit në Kosovë MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht me Ministrinë e Financave për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për komunat e Republikës së Kosovës, me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm të përcaktuar me nenin 35, paragrafi 5, 7 dhe 9 brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare nuk qëndron pasi që Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për kompensim të shpenzimeve për shujta i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë Komuna e Suharekës- Drejtoria Komunale e Arsimit në Suharekë. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëses, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë, ndërsa në nenin 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, ndër të tjera thuhet se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.), në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...”*, ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore.

Poashtu pretendimi ankimor i të paditurës se *komuna nuk ka pasur mundësi ti paguajë, për shkak se nuk ka mundësi që në skemën e saj buxhetore të planifikojë linjë të veçantë buxhetore për këtë lloj kompensimi*, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pathemeltë, për faktin se kjo nuk mund të jetë bazë për mospagesën e kësaj shume, pasi që me këtë deklaram vet e paditura në njëfarë forme e ka pranuar kërkesën e palës paditëse, andaj dhe ky pretendim është i paqëndrueshëm dhe nuk ka pasur ndikim në vendosjen ndryshe nga ana e gjykatës së shkallës së dytë.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit që në emër të kompensimit të ushqimit ditor, si t’ia kompensojë shumën e aprovuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Gjithashtu edhe për lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në mënyrë të ligjshme, pasi që në shkresat e lëndës ka pasur prova të mjaftueshme siç është kërkesa drejtuar DKA-së në Suharekë, vërtetimi për ditët e pranisë në pune, nga të cilat edhe është vërtetuar saktësisht lartësia e kërkesëpadisë, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozita e LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore. E drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë edhe sa i përket kërkesës aksesore përkitazi me kamatën.

Meqenëse pika *II (dy)* e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar (nuk është atakuar me ankesë nga ana e palës paditëse), e në ndërkohë e njëjta ka qenë në favor të paditurës, gjykata aktgjykimin në fjalë në këtë pjesë, nuk e ka shqyrtuar.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.8015/22, datë 21.10.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Arsim Hamzaj